

VENDIM
Nr.178, datë 19.2.2009

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “IVOCALAR VIVADENT&PARTNERS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e kolegjit profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” do të ofrojë program studimi, të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të plotë, në “Teknik i lartë dentar”, i cili do të zgjasë 3 vite. Në mbarim të studimeve do të lëshojë “Diplomë të nivelit të parë” (DNP), në “Teknik i lartë dentar”.

3. Ngarkohet kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” që, për programin e studimit, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë, para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Kolegji profesional privat “Ivoclar Vivadent&Partners” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtij programi të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha